

**Deloitte.**



# Tax & Legal *News*

January 2024

## Ligji nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore i cili rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Kosovës që janë në fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ATK), si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të ATK. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohen Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligji Nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat; dhe Ligji Nr. 04/L-223 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102.

Hyryra në fuqi e Ligjit të ri për procedurat tatimore është ndryshimi më substancial i legjislacionit tatimor në dekadën e fundit. Ligji i ri parasheh ndryshime të thukta në fusha nga më të ndryshmet, ku ndryshimet më substanciale i kemi përmbledhur në këtë publikim në pika të shkurta.

### Ndryshimet lidhur me kreditimet dhe rimbursimet tatimore:

**Në lidhje me deklaratat tatimore, është ulur e drejta e korrigjimit të deklaratave tatimore nga 6 vite mbrapa, në 3 vite mbrapa.**

Ndërsa për korrigjimet e deklaratave të TVSH-së të periudhave që janë më të vjetra se sa periudha kur ATK ka kryer një vlerësim të TVSH-së, duhet marrë aprovim paraprak nga ATK.

Sa i përket kreditimeve dhe rimbursimeve, çdo pagesë tepër e tatimit do të kreditohet automatikisht kundrejt çdo borxhi eventual tatimor apo kontribute, pa ndonjë kërkesë të tatimpaguesit. Kurse rimbursimi i tatimit do të kryhet vetëm me kërkesë të tatimpaguesit.

**Kreditimi i pagesave tepër apo kërkesa për rimbursim të tatimeve do të jetë i mundshëm vetëm për periudha tatimore që nuk janë më të vjetra se tri vite (është zvogëluar nga 6 vite në 3 vite).**

Për më tepër, është shkurtuar afati për shqyrtimin e kërkesës për rimbursim nga 60 ditë në 30 ditë.

Në rast se tatimpaguesi është në kreditim të vazhdueshëm të TVSH-së për më shumë se tre muaj dhe ka një borxh tatimor mbi 5,000€, do të iniciohet nga ATK procesi i rimbursimit të TVSH-së për të mbuluar borxhin dhe nëse kreditimi i TVSH-së ka qenë më i lartë se borxhi diferenca do t'i rimbursohet tatimpaguesit.

### Ndryshimet lidhur me përcaktimin e gjobave:

Ka pasur ndryshime substanciale edhe për çështje të përcaktimit të gjobave për mos-përmbushje tatimore si vijon:

Gjopa për mos deklarim është ndryshuar nga 5% në muaj të detyrimit tatimor të pa deklaruar deri në maksimum 5 muaj siç ka

## Law no. 08/L-257 on the Administration of Tax Procedures

The Assembly of the Republic of Kosovo has approved Law no. 08/L-257 for the Administration of Tax Procedures, which regulates the procedures for the administration of tax obligations in the Republic of Kosovo that are within the scope of the Tax Administration of Kosovo (hereinafter: TAK), as well as the principles of organizing and operation of TAK. With the entry into force of this Law, the following are repealed: Law No. 03/L-222 on Tax Administration and Procedures, Law No. 04/L-102 on Amendment and Supplement to Law No. 03/L-222 for Tax Administration and Procedures; and Law No. 04/L-223 on Supplementing and Amending Law No. 03/L-222 on Tax Administration and Procedures.

The entry into force of the new Law on tax procedures is the most substantial change in tax legislation in the last decade. The new law foresees significant changes in various fields, the most important of which we have summarized in this publication.

### Changes related to tax credits and refunds:

**In regard to tax returns, the right to correct tax returns has been reduced from 6 years back to 3 years back.**

As for the corrections of VAT declarations for periods that are older than the period when TAK performed a VAT assessment, prior approval must be obtained from TAK.

Regarding tax credits and refunds, any overpayment of tax will be automatically credited against any eventual tax debt or contributions, without any request from the taxpayer. However, the tax refund will be carried out only at the request of the taxpayer.

**Crediting of overpayments or requests for tax refunds will be possible only for tax periods that are not older than three years (it has been reduced from 6 years to 3 years).**

In addition, the deadline for reviewing the refund request has been reduced from 60 days to 30 days.

In case the taxpayer is in continuous VAT credit for more than three months and has a tax debt over 5,000€, the VAT refund process will be initiated by TAK to cover the debt and if the VAT credit was higher than the debt, the difference will be reimbursed to the taxpayer.

### Changes regarding assessment of penalties for non-compliance:

There have been substantial changes in matters of determining penalties for non-compliance as follows:

The penalty for non-declaration has been changed from 5% per month of the undeclared tax liability up to a maximum of 5 months, and has been

qenë dhe është zëvendësuar me masa ndëshkuese fikse për çdo deklaratë të pa deklaruar e cila rezulton me detyrim tatimor si vijon:

- pesëdhjetë euro (50.00€) për personin fizik afarist;
- njëqindpesëdhjetë euro (150.00€) për personin juridik;
- njëzet euro (20.00€) për personin fizik jo afarist.

Gjithashtu është eliminuar gjoba për pagesë me vonesë që ka qenë 1% në muaj deri në maksimum 12 muaj apo 12%.

Sa i përket masave ndëshkuese administrative për mos mbajtje të regjistrimeve, është bërë një ndryshim i shkallëve të qarkullimit vjetor për përcaktimin e masave ndëshkuese si dhe shuma e aplikueshme, si më poshtë:

- Për tatimpaguesit me qarkullim vjetor deri tridhjetëmijë Euro (30,000€), ndëshkim administrativ prej njëqindnjëzetepesë Euro (125€) është rritur në shumën prej njëqindpesëdhjetë Euro (150€);
- Për grupin e tatimpaguesve me qarkullim vjetor nga tridhjetëmijë Euro e një cent (30,000.01€) deri në pesëqindmijë euro (500,000.00€), nuk ka pasur ndonjë ndryshim në shumën e ndëshkimit të aplikueshëm. apo;
- Për tatimpaguesit me qarkullim vjetor prej pesëqindmijë euro e një cent (500,000.01€) deri në pesëmilion euro (5,000,000.00€) është caktuar ndëshkimi administrativ prej njëmijë Euro (1,000€);
- Për tatimpaguesit me qarkullim vjetor prej pesëmilionë euro e një cent (5,000,000.01€) e më shumë është caktuar ndëshkimi administrativ në lartësi prej dymijë euro (2,000.00€).

Në lidhje me ndëshkimet, ATK-ja ndalon ushtrimin e veprimtarisë së biznesit në pikat e shitjes në rastet kur aplikohen ndëshkime të vazhdueshme, si:

- shtatë (7) ditë kalendrike në rastet kur aplikohen tri (3) ndëshkime në data të ndryshme brenda vitit kalendrik;
- pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike në rastet kur aplikohen katër (4) ndëshkime në data të ndryshme brenda vitit kalendrik.

Rritet niveli i gjobës për mallrat e pa dokumentuara nga 15% në vlerën e tregut të atyre mallrave në 30% të vlerës së tregut të tyre.

**Çdo ndëshkim i aplikuar sipas këtij Ligji, përveç gjobave për mos mbajtje të tatimit në burim, nëse paguhet brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga data e njoftimit për aplikim të gjobës, paguhet vetëm pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së gjobës të aplikuar.**

Sa i përket përllogaritjes së interesit për pagesat me vonesë, shkalla e aplikuar do të përcaktohet nga Ministria e Financave, e cila do të duhet të jetë më e lartë se shkalla e interesit që aplikojnë bankat në Kosovë. Gjithashtu, një ndryshim tjetër me këtë ligj është edhe kufizimi i përllogaritjes së interesit, që tani kufizohet në maksimum 10 vite interes të përllogaritur.

replaced with fixed punitive measures for each undeclared declaration which results in a tax liability, as follows:

- fifty euros (50.00€) for the individual business person;
- one hundred and fifty euros (150.00€) for the legal entity;
- twenty euros (20.00€) for a non-business natural person.

The penalty for late payment has also been eliminated, which used to be 1% per month up to a maximum of 12 months or 12%.

As for administrative penalties for failure to keep records, a change has been made to the annual turnover bracket for determining the penalties as well as the applicable amount, as follows:

- For taxpayers with an annual turnover of up to thirty thousand Euros (30,000€), the administrative penalty of one hundred twenty-five Euros (125€) has been raised to one hundred and fifty Euro (150€);
- For the group of taxpayers with annual turnover from thirty thousand Euros and one cent (30,000.01€) up to five hundred thousand euros (500,000.00€) there have been no changes to the applicable penalties;
- For taxpayers with annual turnover of five hundred thousand euros and one cent (500,000.01€) to five million euros (5,000,000.00€) - administrative penalty of one thousand euros (1,000€) euros is applicable;
- For taxpayers with annual turnover of five million euros and one cent (5,000,000.01€) or more - administrative penalty of two thousand euros (2,000€) euros is applicable;

Regarding the penalties, TAK prohibits the exercise of business activity at the points of sale in cases where continuous penalties are applied, such as:

- seven (7) calendar days in cases where three (3) penalties are applied on different dates within the calendar year;
- fifteen (15) calendar days in cases where four (4) penalties are applied on different dates within the calendar year.

The amount of the fine for undocumented goods has been increased from 15% of the market value of those goods to 30% of their market value.

**Any penalty applied under this Law, except fines for failure to withhold tax, if paid within fifteen (15) calendar days from the date of notification of the application of the fine, only fifty percent (50%) of the value of the applied fine shall be paid.**

As for the calculation of interest for late payments, the applied rate will be determined by the Ministry of Finance, which will have to be higher than the interest rate applied by banks in Kosovo. In addition, another change in this law is the limitation of interest calculation on late payments, which is now limited to a maximum of 10 years of calculated interest.

### Ndryshimet në procedurat e kontrollës dhe ankesave:

Ulet afati i Shqyrtimit të një Ankesë nga 60 ditë në 45 ditë nga dita e dorëzimit të saj. Tatimpaguesi i cili nuk pajtohet me një vendim të Ankesave, brenda tridhjetë (30) ditëve mundet të paraqesë ankesë në Bord. Bordi i Ankesave nxjerr vendim brenda 30 dite nga dita e pranimit të saj.

**Një ndryshim i rëndësishëm rreth procedurës ankimore brenda ATK-së ka të bëjë me themelimin e Bordit të Ankesave, si shkallë e dytë administrative në procedurë Ankimore. Bordi do të shqyrtojë ankesat në lidhje me vlerësimet nga ATK dhe Dogana e Kosovës si dhe do të jetë trupë e pavarur brenda Ministrisë së Financave. Ky bord do të themelohet brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit.**

Jepet mundësia për të shtyrë veprimin e mbledhjes së tatimit para se të bëjë një ankesë te Bordi apo gjykata kompetente. Kjo mundësohet duke dorëzuar një garancion bankar ose formë tjetër të sigurisë të pranueshme nga ATK, për një shumë të mjaftueshme për të mbuluar tatimin, gjobën, dhe interesin e tillë që mund të rritet gjatë çdo veprimi pasues.

Gjithashtu është paraparë proces ankimor për vendosje të gabuar të barrës tatimore nga ATK.

ATK ka të drejtë që të përdorë si dëshmi për vlerësim edhe informatat në formë të fotove të momentit apo videoinqizimeve të publikuara nga tatimpaguesit.

### Ndryshimet e tjera:

Ligji i ri parasheh ndryshim të rolit të obligimeve të përfaqësuesve juridik, duke përfshirë:

- Fillimisht, ligji bën përkufizimin e këshilltarit tatimor dhe përgjegjësitë e tyre. Këshilltarët tatimorë duhet të licencohen nga ATK pas përfundimit të trajnimit dhe testimit të suksesshëm.
- Tutje, ligji ngarkon me përgjegjësi përfaqësuesit e autorizuar që të sigurohen se tatimet janë deklaruar në kohë, saktë dhe janë paguar nga kompania që ata përfaqësojnë. Tatimpaguesi apo përfaqësuesi i tij që nënshkruan një deklaratë tatimore e cila ka informata të rreme ngarkohet me përgjegjësi penale.
- Gjithashtu, ligji parasheh ndëshkim me 150.00€ për secilin person i cili nënshkruan një deklaratë tatimore në emër të një personi tjetër dhe i cili bën një gabim në atë deklaratë. Tatimpaguesi jo-rezident i cili përfaqësohet nga një person në Kosovë, duhet të informojë ATK-në për përfaqësuesin e tij brenda tre (3) javësh pasi të ketë filluar të sigurojë të ardhura ose të ketë blerë pasuri në Republikën e Kosovës.

Regjistrimi i çdo entiteti që përfshinë në listën e zyrtarëve apo drejtorëve (përfshirë drejtorin menaxhues dhe/apo përfaqësuesin përgjegjës) person/a me një histori të mos-përbushjes (mos-dorëzimit e deklaratave apo mos-pagesën e obligimeve tatimore)

### Changes in tax audit and appeals procedures:

The deadline for Reviewing a Complaint is reduced from 60 days to 45 days from the day of its submission. The taxpayer who does not agree with a decision of the Appeals, within thirty (30) days can submit an appeal to the Board. The Appeals Board issues a decision within 30 days from the day of its acceptance.

**A significant change with respect to appeals procedures within the TAK relates to the establishment of the Board of Appeals as the second administrative level in the Appeals procedure. The Board will consider complaints regarding assessments by TAK and Kosovo Customs and will be an independent body within the Ministry of Finance. This board will be established within 6 months from the day of entry into force of the law.**

The opportunity is given to postpone the action of tax collection before making a complaint to the Board or the competent court. This is made possible by submitting a bank guarantee or other form of security acceptable to TAK, for an amount sufficient to cover the tax, fine, and such interest that may accrue during any subsequent action.

Additionally, an appeals process for wrongly setting the tax burden by TAK is foreseen.

TAK has the right to use as evidence for assessment information in the form of current photos or video recordings published by taxpayers.

### Other changes:

The new law foresees a change in the role of obligations of legal representatives, including:

- Firstly, the law defines the tax advisor and their responsibilities. Tax advisors must be licensed by TAK upon successful completion of training and testing.
- Further, the law charges authorized representatives with responsibility to ensure that taxes are timely, accurately declared and paid by the company they represent. The taxpayer or their representative who signs a tax return that contains false information is charged with criminal liability.
- Also, the law provides a penalty of 150.00€ for each person who signs a tax return on behalf of another person and who makes a mistake in that return. The non-resident taxpayer who is represented by a person in Kosovo, must inform TAK about his representative within three (3) weeks after he has started to provide income or has purchased assets in the Republic of Kosovo.

Registration of any entity that includes in the list of officers or directors (including the managing director and/or responsible representative) a person/s with a history of non-compliance (non-submission of declarations or non-payment of tax obligations) in any entity of previously in which they

në çdo entitet të mëhershëm në të cilin ai ka qenë ortak, pronar, drejtor menaxhues, apo përfaqësues tjetër përgjegjës mund të refuzohet nga ATK.

Ndërsa sa i përket çregjistrimit, ulet afati për dhënien e aprovimit për çregjistrim të tatimpaguesit pas kërkesës së tij nga 60 në 45 ditë.

Në pasqyrë të informatave përfshihen edhe fatura dhe kuponit fiskal, që nënkupton se mund të bëhen subjekt i ndëshkimeve për mos raportime të sakta, përveç për mos mbajtje të regjistrimeve.

**Vlera e transaksioneve që kërkohet të kryhet përmes llogarisë bankare mes të personave që zhvillojnë aktivitet ekonomik është ulur nga 500€ në 300€. Gjithashtu, me Udhëzim Administrativ do të përcaktohen kriteret që transaksionet në mes të personave fizik dhe atyre të përfshirë në aktivitet biznesor të bëhen përmes llogarisë bankare.**

**Kërkohet që çdo punëdhënës të informojë ATK-në një ditë para fillimit të punës së çdo punëtori të tij. Forma e njoftimit do të përcaktohet nga ATK. Gjithashtu, kërkohet që pagat të paguhen vetëm përmes institucioneve financiare.**

Zyrtarizohet me Ligj pozita e Avokatit të Tatimpaguesit brenda ATK-së, por detyra e tyre është e kufizuar vetëm me të drejtën e sigurimit të respektimit të procedurave dhe jo në vendimet lidhur me shumatat e vlerësuara të detyrimeve tatimore.

ATK do të mund të publikojë të gjithë tatimpaguesit të cilët pas një kontrolli të kryer kanë rezultuar me shmangie tatimore duke respektuar Ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

Ky Ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 12 janar 2024 dhe do të hyjë në fuqi më 28 janar 2024.

were a partner, owner, managing director, or other responsible representative may be rejected by TAK.

As for deregistration, the deadline for granting approval for deregistration of the taxpayer after his request is reduced from 60 to 45 days.

Invoices and fiscal coupons are also included in the overview of information, which means that they can be subject to penalties for not reporting correctly, in addition to not keeping records.

**The value of transactions that are required to be carried out through the bank account between persons who develop economic activity has been reduced from 500€ to 300€. In addition, it is stipulated that an Administrative Instruction will set forth criteria regarding transactions between individuals and business entities requiring them to be conducted through bank account.**

**Each employer is required to inform TAK one day before the start of work of each of his workers. The form of notification will be determined by TAK. Also, it is required that salaries are paid only through financial institutions.**

The position of the Taxpayer's Advocate within TAK is authorized by law, but their duties are limited only to the right to ensure compliance with procedures and not to decisions regarding the estimated amounts of tax liabilities.

TAK will be able to publish all taxpayers who, after an audit, have resulted in tax evasion in compliance with the Data Protection Law.

This Law was published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo on January 12, 2024, and will enter into force on January 28, 2024.

## Shpalosje

Ky komunikim përmban vetëm informacione të përgjithshme dhe asnjë nga Deloitte Touché Tohmatsu Limited, ndonjë nga firmat e saj anëtare ose ndonjë nga filialet e sipërpërmendur (bashkë "Deloitte Network") nuk janë, përmes kësaj komunikate, duke ofruar këshillë profesionale apo shërbime.

Ky komunikim nuk është një zëvendësim për këshilla ose shërbime të tilla profesionale, as nuk duhet të përdoret si bazë për ndonjë vendim ose veprim që mund të ndikojë në financat ose biznesin tuaj. Përpara se të merrni ndonjë vendim ose të ndërmerrni ndonjë veprim që mund të ndikojë në financat ose biznesin tuaj, duhet të konsultoheni me një këshilltar profesionist të kualifikuar. Asnjë entitet në Rrjetin Deloitte nuk do të jetë përgjegjës për çfarëdo humbje të shkaktuar nga çdo person që mbështetet në këtë komunikim.

\*\*\*

Deloitte i referohet një ose më shumë prej Deloitte Touche Tohmatsu Limited (DTTL), rrjetit të saj global të firmave anëtare dhe entiteteve të tyre të lidhura (bashkë, "organizata Deloitte"). DTTL (i referuar edhe si "Deloitte Global") dhe secila prej firmave të saj anëtare dhe subjekteve të lidhura janë ligjërisht entitete të veçanta dhe të pavarura, të cilat nuk mund të detyrojnë ose detyrojnë njëra-tjetrën në lidhje me palët e treta. DTTL dhe çdo firmë anëtare e DTTL dhe subjekt i lidhur është përgjegjës vetëm për veprimet dhe mosveprimet e veta, dhe jo ato të njëri-tjetrit. DTTL nuk ofron shërbime për klientët. Ju lutemi shikoni [www.deloitte.com](http://www.deloitte.com) për të mësuar më shumë.

Deloitte ofron shërbime udhëheqëse në fushën e auditimit dhe sigurisë, shërbime këshilluese tatimore dhe ligjore, konsultimeve, këshillimeve financiare dhe shërbimeve konsultuese për rreziqet e bizneseve, për pothuajse 90% të kompanive në Fortune Global 500® dhe mijëra kompani private. Njerëzit tanë sjellin rezultate të matshme dhe të qëndrueshme që ndihmojnë në përkrahjen e besimit publik në tregjet e kapitalit, lejojnë klientët të transformohen dhe përparojnë, dhe udhëheqin drejt një ekonomie më të fortë, një shoqërie më të drejtë dhe një bote të qëndrueshme. Duke ndërtuar mbi historinë e saj prej mbi 175 vitesh, Deloitte shtrihet në më shumë se 150 vende dhe territore. Mësoni si rreth 457,000 persona të Deloitte në të gjithë botën kanë një ndikim të rëndësishëm në [www.deloitte.com](http://www.deloitte.com).

### Afrore Rudi

**Partner** | Tax and Legal  
Mobile: +383 49 590 807  
Email: [arudi@deloittece.com](mailto:arudi@deloittece.com)

### Ruzhdi Zenelaj

**Senior Expert** | Tax and Legal  
Mobile: +383 49 283 105  
Email: [rozenaj@deloittece.com](mailto:rozenaj@deloittece.com)

## Disclaimer

This communication contains general information only, and none of Deloitte Touche Tohmatsu Limited ("DTTL"), its global network of member firms or their related entities (collectively, the "Deloitte organization") is, by means of this communication, rendering professional advice or services.

This communication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this communication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited (DTTL), its global network of member firms, and their related entities (collectively, the "Deloitte organization"). DTTL (also referred to as "Deloitte Global") and each of its member firms and related entities are legally separate and independent entities, which cannot obligate or bind each other in respect of third parties. DTTL and each DTTL member firm and related entity is liable only for its own acts and omissions, and not those of each other. DTTL does not provide services to clients. Please see [www.deloitte.com](http://www.deloitte.com) about to learn more.

Deloitte provides industry-leading audit and assurance, tax and legal, consulting, financial advisory, and risk advisory services to nearly 90% of the Fortune Global 500® and thousands of private companies. Our people deliver measurable and lasting results that help reinforce public trust in capital markets, enable clients to transform and thrive, and lead the way toward a stronger economy, a more equitable society, and a sustainable world. Building on its 175-plus year history, Deloitte spans more than 150 countries and territories. Learn how Deloitte's approximately 457,000 people worldwide make an impact that matters at [www.deloitte.com](http://www.deloitte.com).

### Florin Gjota

**Senior Manager** | Tax and Legal  
Mobile: +383 49 882 918  
Email: [fgjota@deloittece.com](mailto:fgjota@deloittece.com)

### Mal Osmani

**Manager** | Tax and Legal  
Mobile: +383 49 780 104  
Email: [mosmani@deloittece.com](mailto:mosmani@deloittece.com)